



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.57/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.01.2025, merr këtë:

**VE N D I M**

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.57/2025 e datës 17.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,500.00 (tremijepesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datë 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se më 16 janar 2025, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vendosur Billboard/ posterë në hapësirat e Stadiumit “Shahin Haxhiislami”, në rrugën “UÇK”, në Pejë.

Tutje në ankesë theksohet se ky veprim i subjektit politik LDK, është në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nenin 7 par.2 pika 2.4. Pra, materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset në objekte që janë në pronësi shtetërore. Konkretisht, neni 7 paragrafi 2.4 Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e

Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar parasheh” Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset si në vijim: 2.4. objekteve në pronësi shtetërore”

Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e Billboards/posterëve në kundërshtim me rregullativën zgjedhore.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 18.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) lidhur me pretendimet se subjekti politik LDK ka shkelur nenin 7 paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të Rregullores Nr.07.2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar me rastin e vendosjes së billboardit/posterit është e diskutueshme për nga ana ligjore, sepse hapësirat ku është vendosur nuk ka të bëjë me pronësi shtetërore dhe është hapësirë e shkëputur dhjetëra metra nga stadioni “Shahin Haxhi Islami” në Pejë dhe e dedikuar për reklama e të ngjashme, për çka e dëshmojnë fotot e bashkangjitura si provë.

Në vazhdim të përgjigjes theksohet se vet subjekti politik që ka paraqitur ankesën ka të vendosur poster të subjektit dhe kandidatit të tyre për deputet në Pejë-z. Raif Qavolli, madje nuk ka arritur që si ankues që ka barrën e provës të aprovoj se hapësira në fjalë është në pronësi shtetërore, sepse siç shihet nga fotot e bashkangjitura ka reklama edhe nga biznese të ndryshme që faktojnë se ajo është hapësirë e dedikuar për reklama e të ngjashëm, por megjithëse që personi përgjegjës që përkujdeset për këto hapësira reklamuese ka larguar posterin, pavarësisht që nga KKZ, në Pejë ka marrë përgjigje pozitive verbale se mund të vendosen poster tillë.

Kërkojnë nga PZAP- që të merr vendim meritor për rastin në fjalë dhe duke u bazuar në krejt ato që u than, kërkojnë që ankesa e subjektit politik LVV të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Sipas Panelit Subjekti Politik LDK nuk ka siguruar asnjë provë për të dëshmuar se ka marrë leje nga ndonjë autoritet kompetent për të shfrytëzuar qoftë hapësirën publike apo atë private për qëllim të vendosjes së posterëve të tyre në fushatë zgjedhore. Njëherit konstatimi i subjektit politik se ka marrë përgjigje pozitive verbale nga KKZ, kjo për panelin nuk paraqet rrethanë që përjashton nga përgjegjësia për shkeljen e bërë, ngase është më se e qartë se sipas cilës procedurë duhet vendosur posteret e tillë gjatë fushatës zgjedhore, që kjo në këtë rast nuk është respektuar nga subjekti politik në fjalë. Paneli vlerëson se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira shtetërore gjegjësisht në hapësirën e Stadiumit “Shahin Haxhiislami”, në rrugën “UÇK”, në Pejë, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartë cekur të rregullës zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh faktin që subjekti politikë në fjalë ndërkohë ka larguar posterin nga hapësira e caktuar, ndërsa për bazë është marrë edhe natyra e shkeljes dhe ndikimit të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes dhe përsëritjen e shkeljes së njëjtë nga subjekti në fjalë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.57/2025 më datën 19.01.2025

**Kryesues i Panelit  
Kujtim Pasuli**

